



Funded by
the European Union

Pagesa e polisave kufitare nga buxheti i shtetit



Shtator 2021

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

3 Hyrje

4 Të hyrat dhe shpenzimet nga polisat kufitare

5 Mbështetja e diasporës dhe remitencat

8 Përfundim



Funded by
the European Union

KOSOVO 2.0

gap INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

Hyrje

Kosova është vendi i vetëm në territorin e Evropës që nuk është anëtare e sistemit të "Kartonit të Gjelbër", një mekanizëm i përbashkët i 48 shteteve për sigurimin e viktimave të aksidenteve motorike ndërkuftare.¹ Sistemi i "Kartonit të Gjelbër" është themeluar më 1949, i nxitur nga Këshilli Ekonomik për Evropë i Kombeve të Bashkuara².

Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe as e Këshillit Ekonomik dhe Social dhe trupave punuese si Komiteti për Transport të Brendshëm, dhe kjo është përmendur si arsye e shpeshtë se përse Kosova, përmes Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), nuk është anëtare e "Kartonit të Gjelbër". Mirëpo, në sesionin e 106-të të Komitetit për Transport të Brendshëm, të mbajtur në tetor të vitit 2011 është lënë hapur mundësia që Kosova të pranohet në "Kartonin e Gjelbër", përkundër mosnjohjes zyrtare si shtet.³

Por, një nga pengesat praktike për aplikim për anëtarësim në "Kartonin e Gjelbër" është edhe numri i lartë i veturave të pa regjistruara në Kosovë. Sipas BKS-së, 30% e veturave në Kosovë janë pa regjistrim dhe para aplikimit për anëtarësim duhet që ky numër të ulet në 5%.⁴ Për të ulur numrin e veturave të paregjistruara, institucionet shtetërore kanë marr masa të ndryshme, siç është aprovimi i rregullores për pagesa shtesë për vonesat në regjistrim të veturave⁵, apo edhe thirrjet publike për kompanitë për furnizim me tiketa ngjitëse për identifikimin më të lehtë të veturave të paregjistruara.

Pasi që Kosova nuk është pjesë e "Kartonit të Gjelbër", sigurimi i veturave i lëshuar në Kosovë nuk vlen për vendet tjera, si dhe veturat që hynë në Kosovë duhet të paguajnë sigurim shtesë, pavarësisht nëse kanë apo jo "Karton të Gjelbër".

Pagesa në kufi për sigurimin e autopërgjegjësive ka qenë një ndër ankesat e vazhdueshme të diasporës, kryesisht për shkak të vonesave në kufi dhe kostos relativisht të lartë.⁶ Me qëllim të lehtësimit të pritjeve në kufi për diasporën dhe si masë për të motivuar ardhjen e diasporës në një kohë të krizës më të madhe ekonomike që nga paslufta, si pasojë e masave kufizuese për parandalimin e pandemisë nga virusi Covid-19, në vitin 2020 institucionet e Kosovës morën përsipër që të paguajnë polisat e sigurimit për pjesëtarët e diasporës dhe të gjithë ata që hynë me automjete të huaja përmes rrugëve tokësore në Kosovë.

Duke u bazuar në të dhëna statistikore për numrin e polisave kufitare, në këtë raport të shkurtër do të analizohen vendimet qeveritare sa i përket lirimit nga pagesa të sigurimit kufitar të autopërgjegjësive, ndikimin buxhetor dhe procedurat e zbatimit të politikave të tilla.

1 Council of Bureaux. The Green Card System. Burimi: <https://bit.ly/3kgf1hu>

2 Ang. United Nations Economic Commission for Europe - UNECE

3 United Nations - Economic and Social Council, Inland Transport Committee of Economic Commission for Europe. Working Party on Road Transport, 106th session. Geneva, 17-19 October 2011. Burimi: <https://bit.ly/3Eppjnv>

4 Radio Evropa e Lirë. Nadie Ahmeti&Luljeta Veseli-Krasniqi. Aplikimi për Kartonin e Gjelbër, vetëm pas shtatorit 2021. Prishtinë, 23 nëntor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3xEOfG>


5 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Rregullorja për zbatimin e sistemit bonus-malus. 12 qershor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3lBweBl>

6 Germin. Analizë e shkurtër e politikave mbi sigurimin kufitar për mërgimtarët. Maj 2018. Burimi: <https://bit.ly/3CnAkDY>

Të hyrat dhe shpenzimet nga poliset kufitare

Nga viti 2002 deri në vitin 2020, të hyrat e kompanive të sigurimeve nga poliset kufitare sillen mesatarisht nëntë milionë euro në vit.

Grafikoni 1. Të hyrat vjetore nga poliset kufitare 2002 – gusht 2021




Burimi: GAP, bazuar në seritë kohore të BQK dhe të dhënat e BKS për muajin gusht 2021

Të hyrat nga poliset kufitare përbëjnë në mesatare rreth 8% të të hyrave vjetore të kompanive të sigurimeve.

Që nga viti 2002, kompanitë e sigurimeve shesin mesatarisht 260 mijë polisa kufitare në vit. Siç tregon Grafikoni 2, në një vit ky numër ka shkuar deri në mbi 480 mijë polisa kufitare të shitura, apo më shumë se sa vetura të regjistruara brenda vendit.

Grafikoni 2. Numri i polisave kufitare të shitura 2002 – gusht 2021




Burimi: GAP, bazuar në seritë kohore të BQK dhe të dhënat e BKS për muajin gusht 2021

Sa i përket dëmeve të paguara, kompanitë e sigurimeve shpenzojnë mesatarisht 1.2 milion euro në vit. Viteve të fundit vërehet një rritje e dëmeve të paguara dhe bazuar në pagesat deri në korrik të vitit 2021, duket se ky vit do të jetë vit rekord sa i përket shpenzimeve për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga veturat e siguruar përmes polisave kufitare.

Vonesat në pagesat e dëmeve si pasojë e procedurave të gjata gjyqësore është edhe një ndër shqetësimet e pjesëtarëve të mërgatës sa i përket polisave kufitare.⁷

Grafikoni 3. Shuma e dëmeve të paguara për polisat kufitare 2003 - korrik 2021



Burimi: GAP, bazuar në seritë kohore të BQK

Mbështetja e diasporës dhe remitencat

Në vitin 2020, në mbledhjen e fundit të Qeverisë Kurti 1, u mor vendim që të fillohen procedurat për krijimin e një mekanizmi për mbulimin e obligimeve të sigurimit kufitar nga Qeveria e Kosovës për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që janë subjekt i polisës kufitare dhe vijnë në Kosovë për vitin 2020.⁸ Për zbatimin e këtij vendimi u ndanë tre milionë euro. Më 1 gusht 2020, ishte lëshuar edhe polisa e parë kufitare sipas vendimit të qeverisë dhe deri më 31 dhjetor 2020 u shpenzuan rreth 2 milionë euro.

Me programin zgjedhor para zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje kishte premtuar se në mandatin e tyre qeverisë 'nuk do të ketë më karton në gjelbër për mërgatën'.⁹

Pas marrjes së mandatit qeverisë (22 mars 2021), Qeveria Kurti 2 në mbledhjen e saj të mbajtur më 22 qershor 2021, aprovoi kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) për mbulimin e plotë të obligimeve të primit të sigurimit kufitar, për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që janë subjekt i polisës kufitare dhe vijnë në Kosovë deri në fund të vitit 2021.¹⁰

7 Germin. Analizë e shkurtë e politikave mbi sigurimin kufitar për mërgimtarët. Maj 2018. Burimi: <https://bit.ly/3CnAkDY>

8 Zyra e Kryeministrit. Mbledhja 39, vendimi 5, datë: 3 qershor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3hnQhLJ>

9 Lëvizja Vetëvendosje. Prioritetet për krejt qytetarët dhe drejt së ardhmes, shkurt 2021. Burimi: <https://bit.ly/3k64CFb> (hapur së fundmi më 13 shtator 2021).

10 Zyra e Kryeministrit. Mbledhja 16, vendimi 19, datë: 22 qershor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3C7Sqd7>

Me të njëjtin vendim, qeveria autorizon MFPT dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), që në emër të Qeverisë të nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe Byronë Kosovare të Sigurimit. Memorandumi i bashkëpunimit u nënshkrua dy ditë më pas, më 24 qershor 2021. Sipas memorandumit, qeveria do të mbulojë 100% të çmimit të vlerës së primit të polisës kufitare, gjersa BQK dhe BSK ulën çmimin e tarifave për 35%. Të gjitha polisat lëshohen në kohëzgjatje prej një muaj.¹¹

Më 14 korrik 2021, Qeveria e Kosovës aprovoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike, plan për të ndihmuar ringjalljen e ekonomisë së goditur nga pandemia Covid-19.¹² Shuma e përgjithshme e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është 420 milionë euro, prej të cilave 190 milionë euro janë financim nga buxheti i shtetit dhe 230 milionë euro janë financim nga huamarrja.


Pakoja e Ringjalljes Ekonomike parasheh: (Masa 1) mbështetje për punësimin (50 milionë euro); (Masa 2) ringjallja e ekonomisë dhe prodhimit (108 milionë euro); (Masa 3) mbështetje për familjen (50 milionë euro); (Masa 4) mbështetjeja për publikën (112 milionë euro); dhe (Masa 5) investime në infrastrukturë dhe ambient (100 milionë euro).

Në kuadër të masës 4 është përfshirë edhe mbështetje e mërgatës në vlerë prej pesë milionë euro. Pas aprovimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 24-të, më 11 gusht 2021, edhe zyrtarisht ndau pesë milionë euro për zbatimin e masës 4.5 për "mbështetjen e mërgatës".¹³ Sipas vendimit, mjetet merren nga kodi buxhetor i Pakos dhe tranferohen në Thesar, prej nga ku pastaj tranferohen në baza mujore në një llogari të veçantë të Byrosë së Sigurimeve, sipas faturës së dorëzuar nga kjo e fundit.

Sipas të dhënave të siguruar nga BKS, deri në fund të muajit gusht 2021, faturat e dorëzuara nga BKS në Thesar për polisat e sigurimit kufitar kapin shumën e 2.4 milionë eurove, apo gati gjysmë e shumës prej pesë milionë euro të ndara nga Qeveria e Kosovës.¹⁴

Sipas vendit të origjinës, shumica e veturave kanë ardhur nga Gjermania, Zvicra dhe Austria.

Grafikoni 4. Polisat kufitare të lëshuara për veturat e huaja sipas vendit të origjinës



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e BKS

11 Kosovapress. Nënshkruhet marrëveshja për mbulimin e polisës së sigurimit për diasporën, korrik 2021.

Burimi: <https://bit.ly/3hXlj42>


12 Zyra e Kryeministrit. Mbledhja 19, vendimi 13, datë: 14 korrik 2021. Burimi: <https://bit.ly/395TbHf>

13 Zyra e Kryeministrit. Mbledhja 24, vendimi 15, datë: 11 gusht 2021. Burimi: <https://bit.ly/3hLUPTh>

14 Instituti GAP. Informata të siguruar nga BKS sipas kërkesës për qasje në informata, 23 shtator 2021.

Në kushte jashtë pandemie, më shumë se gjysma e diasporës realizon tri deri në katër vizita gjatë vitit në Kosovë, ku qëndrimi zgjat nga dy deri në katër javë, duke realizuar shpenzime qindra milionëshe me vlerë deri në rreth 4.6% të Bruto Produktit Vendor, apo 328 milionë euro.¹⁵ Kjo pa llogaritur remitencat, të cilat mesatarisht sillen 621 milionë euro në vit.

Grafikoni 5. Remitencat 2004 - qeshor 2021



Rekordi i remitencave është arritur në vitin 2020, gjithsej 980 milionë euro. Kurse në gjashtë muajt e parë të 2021 janë dërguar 552 milionë euro, apo 117.4 milionë euro më shumë se të njëjtën periudhë të vitit 2020. Duke marr për bazë shpenzimet mesatare vjetore, shpenzimet e diasporës për polisat kufitare sillen rreth 3% të të gjitha shpenzimeve që ata bëjnë në Kosovë.

15 Instituti GAP. Ndikimi i diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë COVID-19. Nëntor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3hMjxm8>

Përfundim

Një nga nën-masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është edhe mbështetja e mërgatës në shumën prej pesë milion euro. Kjo mbështetje nënkupton edhe mbulimin e shpenzimeve të primit të polisës kufitare për të gjithë bashkëatdhetarët dhe të huajt që janë subjekt i polisës kufitare dhe vijnë në Kosovë deri në fund të vitit 2021. Pagesa e polisave kufitare përmes buxhetit shtetëror është kundërshtuar nga organizata të shoqërisë civile, duke e konsideruar të paarsyeshme dhe keqpërdorim të buxhetit të taksapaguesve të varfër për pagesën e sigurimeve të veturave private.¹⁶ Vendimi është kundërshtuar edhe nga përfaqësuesit e sindikatave të punëtorëve të sektorit privat.¹⁷

Pagesa e polisave kufitare nga buxheti i shtetit nuk do duhet të shërbejë si praktikë edhe në vitet e ardhshme. Kjo për faktin se është një shpërndarje e padrejtë e taksave të qytetarëve, duke subvencionuar një kategori të popullsisë në gjendje të mirë financiare.

Në vend të kësaj, në periudhë afatshkurtër, Qeveria e Kosovës, BQK dhe BKS duhet të ua mundësojnë pjesëtarëve të mërgatës dhe të huajve që hyjnë në Kosovë, që polisat kufitare t'i paguajnë në mënyrë elektronike ('online') me qëllim të shkurtimeve të kohës për pritjet në kufi.

Në aspekt afatgjatë, institucionet duhet të sigurohen që numri i veturave të paregjistruara dhe në qarkullim të ulet nga 30% në 5%, dhe kështu, të largohet edhe pengesa praktike për aplikim për anëtarësim në "Kartonin e Gjellbër".

¹⁶ Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Institutit për Politika Zhvillimore, etj. Reagim: Kundërshtim ndaj vendimit të Qeverisë për subvencionimin e sigurimit të automjeteve të huaja që hyjnë në Kosovë me përfitues individët privat, 23 qershor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3zAeCuZ>

¹⁷ Epoka e Re. Azemi: Punëtori me pagë 170 euro të paguajë për polisën kufitare, e papranueshme, 23 qershor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3CrtrS5>



Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0



Funded by
the European Union